

Linku:

[https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/economic-and-fiscal-policy-coordination/eu-economic-governance-monitoring-prevention-correction/european-semester/framework/eu-economic-governance-explained\\_en](https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/economic-and-fiscal-policy-coordination/eu-economic-governance-monitoring-prevention-correction/european-semester/framework/eu-economic-governance-explained_en)

# Shpjegimi i qeverisjes ekonomike të BE-së

Një shpjegim i qeverisjes ekonomike të BE-së

Ky tekst është përkthim i faqes së internetit të BE-së që shpjegon sistemin e Qeverisjes Ekonomike të BE-së

Kriza e fundit ekonomike dhe financiare zbuloi dobësitë në qeverisjen ekonomike të BE-së. BE u përgjigj duke ndërmarrë një varg të gjerë masash për të forcuar qeverisjen e saj dhe për të lehtësuar kthimin në rritje të qëndrueshme ekonomike, krijim të vendeve të punës, stabilitet financiar dhe financa të shëndosha publike. Shtyllat kryesore të këtyre përpjekjeve janë: paketat legislative për të forcuar Paktin e Stabilitetit dhe Zhvillimit, të njohur si "[Pako e gjashtë masave](#)" dhe "[Pako e dy masave](#)", dhe [Traktati për Stabilitet, Koordinim dhe Qeverisje në Unionin Ekonomik dhe Monetar](#). Të gjitha shtetet anëtare të BE-së përveç Republikës Çeke dhe Kroacisë tani e kanë nënshkruar këtë Traktat. "Pako e gjashtë masave" e forcoi Paktin e Stabilitetit dhe Zhvillimit dhe gjithashtu prezantoi një instrument të ri të mbikëqyrjes makroekonomike: [procedurën e mosbalancit makroekonomik](#). "Paketa e dy masave" kërkon që shtetet anëtare të eurozonës të paraqesin Draftin e Planeve Buxhetore për vitin pasues në mes të tetorit. Kjo siguron që politika fiskale të diskutohet në fillim të procesit buxhetor dhe që udhëzimet e Komisionit të mund të merren parasysh para se të miratohen buxhetet kombëtare.

Rregullat zbatohen në kontekstin e Semestrit Evropian, një cikël vjetor i koordinimit dhe mbikëqyrjes së politikave ekonomike të BE-së. Në krahasim me strukturën e mëparshme, ky sistem i integruar siguron që të ketë rregulla më të qarta, përcjellje më të mirë dhe zbatim të përmirësuar nga shtetet anëtare të politikave të zakonshme të dakorduara gjatë tërë vitit. Ai po ashtu mundëson monitorim të rregullt, dhe mundësi të reagimit më të shpejtë para ose në rast të problemeve. Kjo i ndihmon shtetet anëtare të realizojnë zotimet e tyre për reformën dhe buxhetin, ndërsa e bënë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar më të fortë. Duke lejuar më shumë kohë për dialog, Semestri Evropian i riorganizuar, i iniciuar në vitin 2015 dhe i zbatuar më pas, mundëson përfshirje më të madhe të Parlamentit Evropian dhe legjislativave kombëtare, si dhe të partnerëve socialë dhe palëve të interesuara në të gjitha nivelet.

## Koordinimi gjatë tërë vitit: Semestri Evropian

---

Para krizës, planifikimi i politikave ekonomike dhe buxhetore u zhvillua kryesisht në nivel kombëtar, me vetëm një përmbledhje të kufizuar të koordinuar të përpjekjeve kombëtare në nivel të BE-së. Shtetet anëtare pothuajse nuk kishin nevojë të diskutojnë një strategji kolektive për ekonominë e BE-së, ose të eurozonës, si tërësi.

### **Koordinimi dhe drejtimi.**

Semestri Evropian, i aplikuar për herë të parë në vitin 2010, siguron që shtetet anëtare të diskutojnë planet e tyre ekonomike dhe buxhetore me partnerët e tyre në BE në perioda të caktuara në pjesën e parë të vitit, në mënyrë që të mund të ndërmerret veprim shtetëror në pjesën e dytë të vitit, veçanërisht për miratimin e buxheteve për vitin pasues. Ky ndërveprim i hershëm i lejon ata të bëjnë komente për planet e njëri-tjetrit dhe të monitorojnë progresin kolektivisht. Ai gjithashtu u mundëson atyre të marrin më mirë parasysh sfidat e zakonshme. Çdo vit në pranverë, Komisioni analizon në detaje planet e shteteve anëtare të BE-së për reformat makroekonomike, buxhetore dhe strukturore dhe nxjerr rekomandime për 12-18 muajt e ardhshëm të cilat do të miratohen nga Këshilli. Që nga viti 2016, rekomandimet për shtetet anëtare reflektojnë në masë të madhe rekomandimet vjetore për zonën e euros të cilat miratohen përmes një procesi të ngjashëm në fillim të vitit. Komisioni gjithashtu monitoron përpjekjet e shteteve anëtare për të punuar drejt "Evropa 2020", objektivat e BE-së për strategjinë e saj afatgjatë të zhvillimit në fushat e punësimit, arsimit, inovacionit, klimës dhe luftës kundër varfërisë.

### **Një kalendar i qartë**

Cikli i Semestrit Evropian fillon në nëntor me publikimin e Strategjisë Vjetore të Komisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm (ASGS), Raportit të Mekanizmit të Paralajmërimit (RMP), draftit të Raportit të Përbashkët të Punësimit dhe rekomandimet për eurozonën, të shoqëruar nga një dokument i punës së stafit. Strategjia Vjetore e Zhvillimit të Qëndrueshëm përcakton prioritetet e përgjithshme ekonomike dhe sociale për BE-në dhe u ofron shteteve anëtare udhëzime të përgjithshme të politikave për vitin e ardhshëm. Raporti i Mekanizmit të Paralajmërimit është pika fillestare e procedurës vjetore të mosbalancit makroekonomik (PMM). PMM synon të identifikojë rreziqet potenciale në fazën e hershme, të parandalojë shfaqjen e mosbalanceve të dëmshme makroekonomike dhe të korrigjojë mosbalancat tashmë të krijuara në ekonominë e shteteve anëtare, në BE ose në zonën e euros. Rekomandimet për zonën e euros adresojnë çështje kryesore për funksionimin e eurozonës dhe ofrojnë orientime për veprime konkrete për zbatimin e tyre, të cilat pasqyrohen në rekomandimet specifike të vendit, kur është e përshtatshme. Rekomandimet e eurozonës publikohen së bashku me ASGS për të mundësuar integrim më të mirë të eurozonës dhe dimensioneve kombëtare të qeverisjes ekonomike të BE-së dhe kështu të forcojnë procesin e mbikëqyrjes. Rekomandimet e eurozonës shoqërohen me një dokument pune të stafit, Raporti mbi eurozonën. Drafti i Raportit të Përbashkët të Punësimit analizon gjendjen e punësimit dhe atë sociale në Evropë dhe përgjigjet me politika nga shtetet anëtare. Për

më tepër, Komisioni publikon opinionet e tij mbi Projekt-Planet Buxhetore të shteteve anëtare të eurozonës. Këtë vit - për herë të parë - Komisioni prezantoi edhe një komunikim mbi gjendjen fiskale të eurozonës.

Të përgatitur nga diskutimet e nivelit ministror, udhëheqësit e BE-së në mars e shqyrtojnë Strategjinë Vjetore për Zhvillim të Qëndrueshëm, Raportin e Mekanizmit të Paralajmërimit, rekomandimet e eurozonës dhe draftin e Raportit të Përbashkët të Punësimit dhe ofrojnë udhëzime për drejtimin e përbashkët për BE-në dhe eurozonën në tërësi. Rekomandimet e eurozonës miratohen nga Këshilli në shkurt.

Në shkurt, Komisioni publikon një raport të vendit për secilin shtet anëtar ku e analizon gjendjen e tij ekonomike dhe progresin në zbatimin e agjendës së reformës së shtetit anëtar. Për ato shtete anëtare të përzgjedhura në Raportin e Mekanizmit të Paralajmërimit, raporti i vendit përfshin gjetjet e të ashtuquajturës "përmbledhje të hollësishme" të mosbalanceve të mundshme me të cilat përballet shteti anëtar.

Në prill, shtetet anëtare ia paraqesin Komisionit programet e tyre të reformave kombëtare dhe programet e tyre të stabilitetit ose konvergencës (plane trivjeçare të buxhetit, të parat për vendet e eurozonës, ndërsa të fundit për vendet e tjera anëtare të BE-së). Në këto programe, vendet raportojnë për politikën specifike që ato janë duke i zbatuar dhe që synojnë të miratojnë me qëllim të shtimit të vendeve të punës dhe zhvillimit, parandalimit ose korrigjimit të mosbalanceve makroekonomike, dhe për planet e tyre konkrete për të siguruar përputhjen me rekomandimet dhe rregullat fiskale specifike të pazbatuara të BE-së - dhe kur është e aplikueshme - të eurozonës.

Komisioni më pas vlerëson planet e shteteve anëtare dhe paraqet një seri rekomandimesh të reja specifike për secilin prej atyre vendeve në maj. Për shkak të thjeshtësimin të iniciuar në ciklin e Semestrit Evropian 2015, tani ka më pak rekomandime specifike të vendit dhe më të përqendruara sesa më parë. Këto rekomandime të politikave diskutohen ndërmjet shteteve anëtare në Këshill. Udhëheqësit e BE-së i miratojnë ato në qershor para se Këshilli t'i miratojë ato në korrik. Qeveritë pastaj i inkorporojnë rekomandimet në planet e tyre të reformës dhe në buxhetet kombëtare për vitin pasues.

Monitorimi buxhetor intensifikohet në vjeshtë për shtetet anëtare të eurozonës: ato duhet t'ia paraqesin Komisionit Draft Planet Buxhetore për vitin e ardhshëm deri më 15 tetor. Pastaj Komisioni i vlerëson këto Plane kundrejt kërkesave të Paktit të Stabilitetit dhe Zhvillimit dhe rekomandimeve specifike të vendit dhe në nëntor nxjerr një Opinion për secilin prej tyre, në mënyrë që ky udhëzim të merret parasysh kur të finalizohen buxhetet kombëtare. Pastaj Ministrat e Financave dhe/ose të Ekonomisë të eurozonës diskutojnë vlerësimin e Komisionit për draftet e Planeve buxhetore në Këshillin ECOFIN.

Gjatë gjithë vitit, Komisioni është në dialog me palët e interesit dhe me autoritetet e shteteve anëtare për të monitoruar nga afër zbatimin e politikave.

## Buxhetim më i përgjegjshëm

---

Pakti i Stabilitetit dhe Zhvillimit u krijua në të njëjtën kohë me valutën e përbashkët për të siguruar financa të shëndosha publike. Sidoqoftë, siç është treguar gjatë krizës, zbatimi i saj nuk e parandaloi shfaqjen e mosbalanceve serioze fiskale në disa shtete anëtare.

Prandaj ai u reformua përmes "Pakos së gjashtë masave" (e cila u bë ligj në dhjetor 2011) dhe "Pakos së dy masave" (e cila hyri në fuqi në maj 2013), dhe u përforcua nga Traktati Ndërqeveritar për Stabilitet, Koordinim dhe Qeverisje (i cili hyri në fuqi në janar 2013 në 25 vendet nënshkruese të tij). Në janar 2015, Komisioni [lëshoi një Komunikatë](#) për shfrytëzim më të mirë të fleksibilitetit brenda rregullave ekzistuese të Paktit të Stabilitetit dhe Zhvillimit, për të forcuar lidhjen në mes të reformave strukturore, investimeve dhe përgjegjësisë fiskale në mbështetje të vendeve të punës dhe zhvillimit.

### Rregulla më të mira

- **Deficiti total i buxhetit dhe kufijtë e borxhit:** Pakti i Stabilitetit dhe Zhvillimit përcakton kufijtë prej 3% të BPV-së për deficitet dhe 60% të BPV-së për borxhin. Ato mbesin të vlefshme. Një përqendrim më i fuqishëm në borxh: rregullat e reja e bëjnë funksional kufirin ekzistues të borxhit prej 60% të BPV-së. Kjo do të thotë që shtetet anëtare mund të vendosen në Procedurën e Deficitit të Tepruar nëse ato kanë përqindje të borxhit mbi 60% të BPV-së të cilat nuk janë duke u ulur sa duhet (d.m.th. pjesa mbi 60% nuk është duke u ulur për të paktën 5% në vit mesatarisht përgjatë tri viteve).
- **Standard i ri i shpenzimeve:** sipas rregullave të reja, shpenzimet publike nuk duhet të rriten më shpejt se sa rritja e mundshme afatmesme e BPV-së, përveç nëse shoqërohet me rritje adekuate të të hyrave.
- **Rëndësia e pozitës themelore buxhetore:** Pakti i Stabilitetit dhe Zhvillimit më shumë fokusohet në përmirësimin e financave publike në aspektin strukturor (duke marrë parasysh efektet e një rënieje ekonomike ose masave të njehershme për deficitin). Shtetet anëtare i përcaktojnë objektivat e tyre buxhetorë afatmesëm. Komisioni kontrollon nëse objektivat e zgjedhur buxhetorë afatmesëm janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Paktin e Stabilitetit dhe Zhvillimit. Qëllimi është të përmirësohet ekuilibri strukturor dhe konvergimi drejt objektivit buxhetor afatmesëm, me 0.5% të BPV-së në vit si standard. Kjo siguron një diferencë sigurie kundër shkeljes së objektivit të deficitit total prej 3%, ku shteteve anëtare, veçanërisht atyre me nivele borxhi mbi 60% të BPV-së, u kërkohet të bëjnë më shumë në kohëra ekonomikisht të mira dhe më pak në kohëra të këqija.
- **Një pakt fiskal për 25 shtetet anëtare:** nga janari 2014, nënshkruesit në TSCG duhet të kenë objektiva buxhetor afatmesëm, ligjërisht detyrues, të përcaktuar në ligjin kombëtar. Ato po ashtu duhet të kufizojnë deficitet strukturore në 0.5% të BPV-së (ose në 1%, nëse raporti i tyre i borxhit ndaj BPV-së është dukshëm nën 60%). Të gjitha shtetet anëtare përveç Republikës Çeke dhe Kroacisë e kanë nënshkruar këtë Traktat.

Traktati gjithashtu thotë që mekanizmat e korigjimit automatik duhet të vihen në veprim nëse shkelet kufiri i deficitit strukturor (ose rruga e përshtatjes drejt tij), gjë që do të kërkonte që shtetet anëtare të përcaktojnë në ligjin kombëtar se si dhe kur ato do të korigjojnë shkeljen gjatë buxheteve të ardhshme.

- **Fleksibiliteti gjatë krizës:** duke u fokusuar në pozitën themelore të buxhetit për periudhën afatmesme, Pakti i Stabilitetit dhe Zhvillimit mund të jetë fleksibil gjatë një krize. Nëse zhvillimi përkeqësohet papritur, shtetet anëtare me deficite buxhetore mbi 3% të BPV-së mund të marrin kohë shtesë për të korrigjuar ato mangësi, për sa kohë që shtetet anëtare kanë bërë përpjekjen e nevojshme strukturore.
- **Nxitjet për reforma strukturore dhe investime:** udhëzimet e dhëna nga Komisioni në janar 2015 përcaktojnë mënyrat, në kuadër të rregullave ekzistuese të Paktit, për të inkurajuar zbatimin efektiv të reformave strukturore, për të promovuar investimet dhe për të marrë më mirë parasysh ciklin ekonomik në shtetet anëtare individuale.

## Zbatimi më i mirë i rregullave

- **Parandalim më i mirë:** Komisioni dhe Këshilli vlerësojnë nëse shtetet anëtare i përmbushin objektivat e tyre buxhetore afatmesëm, siç përcaktohen në Programet e tyre të Stabilitetit ose Konvergjencës të paraqitura çdo prill. Vlerësimet pastaj përdoren çdo pranverë në Rekomandimet specifike të Komisionit për secilin vend. Kjo bëhet pas opinionëve për draftet e planeve buxhetore që i dorëzohen çdo vit shteteve anëtare të eurozonës në vjeshtë (shih më poshtë).
- **Paralajmërim i hershëm:** përveç rekomandimeve specifike për secilin vend dhe rekomandimeve të dedikuara fiskale, nëse ka ndonjë devijim të konsiderueshëm nga objektivi afatmesëm ose ndryshim të rrugës drejt tij, Komisioni adreson një paralajmërim për shtetin anëtar, i cili duhet të miratohet nga Këshilli. Ky paralajmërim mund të bëhet publik. Pastaj gjendja monitorohet gjatë tërë vitit, dhe nëse nuk korrigohej, Komisioni mund të propozojë një depozitë me interes prej 0.2% të BPV-së (vetëm për eurozonën), e cila duhet të aprovohet nga Këshilli. Kjo mund t'i kthehet shtetit anëtar nëse e korrigjon devijimin.
- **Procedura e deficitit të tepruar (EDP):** nëse shtetet anëtare shkelin kriterin e deficitit ose të borxhit, ato futen në një procedurë të deficitit të tepruar, ku i nënshtrohen një monitorimi plotësues (zakonisht çdo tre ose gjashtë muaj) dhe u caktohet një afat për korrigjimin e deficitit të tyre të tepruar. Komisioni monitoron përputhshmërinë gjatë tërë vitit, bazuar në parashikimet e rregullta ekonomike dhe në të dhënat e Eurostatit. Komisioni mund të kërkojë më shumë informacion ose mund të rekomandojë veprim të mëtejshëm nga ata që rrezikojnë të mos i përmbushin afatet e deficitit të tyre.
- **Sanksione më të shpejta:** për shtetet anëtare të eurozonës në Procedurën e Deficitit të Tepruar, dënimet financiare fillojnë më herët dhe mund të rriten gradualisht. Mosarritja e uljes së deficitit në mënyrë adekuate mund të rezultojë me gjobë prej 0.2% të BPV-së. Gjjobat mund të rriten deri në një maksimum prej 0.5% nëse zbulohet ndonjë mashtrim statistikor. Dënimet mund të përfshijnë pezullimin e financimit rajonal të BE-së, madje edhe për vendet që nuk janë në eurozonë. Paralelisht, 25 shtetet anëtare që kanë nënshkruar TSCG-në mund të gjobiten me 0.1% të BPV-së nëse nuk i integrojnë si duhet dispozitat e saj në ligjin kombëtar.
- **Transparenca dhe automatizimi:** miratimi i Rekomandimeve vjetore specifike për secilin vend ndjek parimin "përmbaju-ose-shpjego", me anë të të cilit shtetet anëtare duhet të arsyetojnë ndryshimet në propozimet fillestare nga Komisioni. Për më tepër, vendimet për shumicën e sanksioneve në bazë të Procedurës së Deficitit të Tepruar tani merren përmes votimit me shumicë të kualifikuar të kundërt (RQMV), që do të thotë se gjjobat konsiderohen se janë aprovuar nga Këshilli përveç nëse një shumicë e kualifikuar e shteteve anëtare i rrëzon ato. Kjo nuk ishte e mundur para se të hynte në fuqi "Pakoja e gjashtë masave". Për më tepër, 25 shtetet anëtare që kanë nënshkruar Kompaktin Fiskal kanë rënë dakord të përsërisin mekanizmin RQMV edhe më herët në proces, për

shembull, kur vendosin nëse do të fusin një shtet anëtar në Procedurën e Deficitit të Tepruar.

## Rritja e mbikëqyrjes në eurozonë

Kriza ka treguar se vështirësitë në një shtet anëtar të eurozonës mund të kenë efekte ngjithëse në të tjerët. Prandaj është autorizuar mbikëqyrja shtesë për të mbajtur nën kontroll problemet para se të përhapen.

"Pakoja e dy masave" futi në zbatim një cikël shtesë të monitorimit për eurozonën, si dhe mbikëqyrje më të rreptë të atyre që përballen me vështirësi më serioze.

Draft Planet Buxhetore: shtetet anëtare të eurozonës (me përjashtim të atyre shteteve anëtare në kuadër të programeve të rregullimit makroekonomik) duhet të paraqesin Draftet e Planeve të tyre Buxhetore për vitin pasues deri më 15 tetor. Komisioni më pas nxjerr një Opinion për këto DPB.

Programet e Partneritetit Ekonomik: shtetet anëtare të eurozonës duhet të paraqesin programe të tilla kur hyjnë në procedurën e deficitit të tepruar (EDP) ose kur marrin një afat të ri të EDP-së. Këto programe të partneritetit ekonomik përmbajnë reforma të hollësishme fiskale dhe strukturore (për shembull, për sistemet e pensioneve, tatimet ose kujdesin shëndetësor publik) që do të korrigjojnë deficitet e shteteve anëtare në një mënyrë të qëndrueshme.

Mbikëqyrje e shtuar: Shtetet anëtare që përjetojnë vështirësi financiare ose që janë në kuadër të programeve të ndihmës parandaluese nga Mekanizmi Evropian i Stabilitetit, vihen nën "mbikëqyrje të shtuar", që do të thotë se ato i nënshtrohen misioneve të rregullta shqyrtuese nga Komisioni dhe duhet të japin të dhëna shtesë, për shembull, për sektorët e tyre financiarë.

Programet e ndihmës financiare: Shteteve anëtare që përjetojnë ose të cilave u kërcënohen vështirësi serioze në lidhje me stabilitetin e tyre financiar, të cilat mund të kenë efekte të konsiderueshme negative në pjesën tjetër të eurozonës, mund t'u kërkohet të përgatisin programe të plota përshtatjes makroekonomike. Ky vendim merret nga Këshilli, duke vepruar me shumicë të kualifikuar, me propozim të Komisionit. Këto programe janë subjekt i misioneve të rishikimit tremujor dhe kushtëzimit të rreptë në këmbim të çfarëdo ndihme financiare.

Mbikëqyrja pas programit: Shtetet anëtare do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes pas programit për sa kohë që 75% e çdo ndihme financiare të tërhequr mbetet e papaguar.

## Procedura e mosbalancit makroekonomik

Bazuar në përvojën e krizës, reformat e "Pakos së gjashtë masave" prezantuan [Procedurën e mosbalancit makroekonomik](#) (PMM) me qëllim të monitorimit dhe

parandalimit të zhvillimeve ekonomike që mund të rrezikojnë stabilitetin makroekonomik (të lidhur, për shembull, me mosbalancet e llogarisë rrjedhëse, efekti i fluskës në pasuritë e patundshme, krizat bankare) dhe nxitjen e rregullimit me anë të politikave të përshtatshme. PMM aplikohet në kuadër të Semestrit Evropian dhe zhvillohet përmes një numri fazash kryesore:

- **Raporti i Mekanizmit të Paralajmërimit:** Shtetet anëtare ekzaminohen për mosbalancë të mundshme në bazë të një tabelë rezultatesh të variablave kryesore, si dhe treguesve ndihmës dhe informacioneve të tjera, për të matur zhvillimet ekonomike përgjatë kohës. Çdo nëntor, Komisioni publikon Raportin e Mekanizmit të Paralajmërimit. Raporti identifikon shtetet anëtare që kërkojnë analiza të mëtejshme (një përmbledhje e hollësishme).
- **Shqyrtimet e hollësishme:** Komisioni e bën një shqyrtim të hollësishëm të atyre shteteve anëtare të identifikuara në AMR që janë potencialisht të rrezikuara nga mosbalancet. Shqyrtimi i hollësishëm verifikon ekzistencën e mosbalancave dhe ashpërsinë e tyre (identifikimi i mosbalancave të tepërta që kërkojnë mbikëqyrje më të madhe). Këto shqyrtime të hollësishme publikohen në pranverë dhe janë pjesë e Raporteve të Semestrit Evropian për Vendet.
- **Rekomandimet** Për vendet e identifikuara me mosbalancë, Komisioni mund të propozojë rekomandime për të adresuar këto mosbalanca, si pjesë e paketës së rekomandimeve specifike për vendet të nxjerra në maj.
- **Monitorimi.** Politikat që synojnë adresimin nga vendet nën mbikëqyrjen e MIP-së monitorohen përmes një sistemi të monitorimit specifik që përfshin misione dhe raporte.
- **Ndiqni deri në identifikimin e pabarazive të tepërta.** Vendet e identifikuara me disbalanca të tepërta marrin rekomandime në lidhje me PMM-në në përpjesëtim me sfidat, dhe monitorim nga afër të veprimeve të ndërmarra. Nëse Komisioni arrin në përfundimin se ekzistojnë mosbalanca të tepruara në një shtet anëtar, ai po ashtu mund të fillojë Procedurën e Mosbalancit të Tepruar (PMT), duke nënkuptuar realizimin dhe miratimin e një plani të veprimit për korrigjim brenda afateve. Komisioni monitoron gjatë tërë vitit se a janë duke u zbatuar politikat që janë në plan. Përsëritja e mosrespektimit të kërkesave të PMT-së mund të çojë në sanksione (që arrijnë në 0.1% të BPV-së, që aplikohet vetëm për vendet e eurozonës).